



KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 3, DATË 09.06. 2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE KOMPETENCAT E KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Në mbështetje të pikës 4 dhe 5 të nenit 9 të Ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", Komiteti i Investimeve Strategjike,

VENDOSI

1. Miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Komitetit të Investimeve Strategjike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI
Edi Rama

* * *

RREGULLORE PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KIS

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton rregullat për mënyrën e funksionimit të Komitetit të Investimeve Strategjike (në vijim KIS), si dhe për ushtrimin e kompetencave të tij.

Neni 2

Baza Ligjore

Komiteti i Investimeve Strategjike funksionon dhe ushtron kompetencat e tij, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, Ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, si edhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3

Statusi i Komitetit të Investimeve Strategjike

1. Komiteti i Investimeve Strategjike është organ administrativ kolegjal i cili funksionon pranë Këshillit të Ministrave.
2. Komiteti i Investimeve Strategjike ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare.
3. Stema përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Komiteti i Investimeve Strategjike”, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Vula zyrtare e Komitetit të Investimeve Strategjike prodhohet, administrohet dhe ruhet si dhe ka formën dhe elementët e përcaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II

KOMPETENCAT, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KIS

Neni 4

Kompetencat e Komitetit të Investimeve Strategjike

Në ushtrimin e detyrave të tij ligjore, Komiteti i Investimeve Strategjike ka këto përgjegjësi:

- a) monitoron funksionimin e sistemit të “dritares unike” për shërbimet ndaj investitorit strategjik;
- b) monitoron performancën e ndikimit të investimeve strategjike e të ecurisë së tyre, si dhe miraton programet konkrete për mbështetjen dhe stimujt për investimet strategjike;
- c) miraton planin e veprimit për masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit;
- d) miraton projektet me statusin “projekt me potencial strategjik”;
- e) ushtron të gjitha kompetencat e tjera të përcaktuara nga legjislacioni për investimet strategjike.

Neni 5

Përbërja e Komitetit të Investimeve Strategjike

1. KIS përbëhet nga:
 - a) Kryeministri i Republikës së Shqipërisë - Kryetar
 - b) Zëvendëskryeministri - Zëvendëskryetar;
 - c) ministri përgjegjës për çështjet e financave - anëtar;
 - d) ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë dhe turizmit - anëtar;
 - e) ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës dhe transportit - anëtar;
 - f) ministri përgjegjës për çështjet e energjisë dhe industrisë - anëtar;
 - g) ministri përgjegjës për çështjet e zhvillimit urban - anëtar;
 - h) ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë- anëtar;
 - i) ministri përgjegjës për mjedisin - anëtar;
 - j) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit - anëtar;
2. Në mbledhjet e KIS ftohen dhe marrin pjesë, rast pas rasti, me të drejtë vote, edhe ministra të tjerë, kur çështjet që do të diskutohen në mbledhje u përkasin fushave të përgjegjësisë që ata mbulojnë.
3. Komiteti i Investimeve Strategjike fton të marrin pjesë në mbledhjet e tij, pa të drejtë vote, drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore, për të dhënë opinionet dhe shprehur mendimet e tyre mbi investimet strategjike që parashikohen të realizohen në zonat e juridiksionit administrativ të tyre.
4. Gjithashtu Komiteti i Investimeve Strategjike mund të ftojë, në rastet kur e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme, edhe përfaqësues të organeve të tjera shtetërore, ekspertë, profesionistë, përfaqësues të shoqërisë civile, investitorët apo persona të cilët mund të japin kontributin e tyre në lidhje me investimet strategjike të propozuara apo me çështje të lidhura me to.
5. Në mbledhjet e KIS, merr pjesë pa të drejtë vote në funksionin e përfaqësuesit të Sekretariatit të KIS, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Neni 6

Organizimi i brendshëm i Komitetit të Investimeve Strategjike

1. Veprimtaria dhe mbledhjet e Komitetit të Investimeve Strategjike drejtohen nga Kryetari.
2. Në rast se Kryetari mungon apo është në pamundësi për të ushtruar kompetencat në drejtimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, Zëvendëskryetari ushtron kompetencat e tij.
3. Funksionet e Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike ushtrohen nga Agjencia Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve drejton dhe organizon veprimtarinë e Sekretariatit Teknik.

Neni 7

Funksionet e Kryetarit të Komitetit të Investimeve Strategjike

Kryetari i Komitetit të Investimeve Strategjike ka këto kompetenca:

- a) thërret mbledhjet e KIS;
- b) drejton mbledhjet e KIS;
- c) miraton rendin e ditës të mbledhjeve të KIS;
- d) vendos rastet në të cilat është e nevojshme pjesëmarrja e ministrave të tjerë ose të drejtuesve të njësive të qeverisjes vendore, në rastet kur në këto mbledhje do të diskutohen çështje të cilat u përkasin fushave të përgjegjësive apo zonave të juridiksionit administrativ të tyre;
- e) drejton dhe i jep detyra sekretariatit të KIS.

Neni 8

Përbërja, organizimi dhe funksionet e Sekretariatit Teknik

1. Sekretariati teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike përbëhet nga 4 (katër) nëpunës të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, me njohuri shumë të mira ligjore dhe/ose financiare.
2. Sekretariati teknik është përgjegjës për mundësimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe mbledhjeve të Komitetit të Investimeve Strategjike. Për këtë qëllim sekretariati teknik merr të gjitha masat dhe kryen çdo veprim të nevojshëm në funksion të organizimit të punës dhe të mbledhjeve të Komitetit të Investimeve Strategjike.
3. Në veçanti sekretariati teknik ushtron këto funksione:
 - a) mbledh, përgatit, administron dhe i vë në dispozicion anëtarëve të Komitetit të Investimeve Strategjike të gjithë dokumentacionin dhe materialet e nevojshme për çështjet që shqyrtohen në mbledhjet e tij;
 - b) funksionon si qendër komunikimi dhe informimi midis Komitetit të Investimeve Strategjike, organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe subjekteve private përgjatë kryerjes së procedurave të parashikuara nga legjislacioni mbi investimeve strategjike;
 - c) njofton me shkrim anëtarët e Komitetit të Investimeve Strategjike, organet dhe subjektet e tjerë pjesëmarrës, në lidhje me mbledhjet e Komitetit të Investimeve Strategjike dhe rendin e ditës së tyre;
 - d) mban procesverbalin e mbledhjeve të Komitetit të Investimeve Strategjike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe merr masat e duhura për regjistrimin audio dhe transkriptimin e tyre;
 - e) i komunikon vendimet e marra në mbledhjet e Komitetit të Investimeve Strategjike, organeve dhe subjekteve përkatës;
 - f) regjistron, publikon dhe arkivon vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - g) mbledh dhe përpilon të dhëna statistikore periodike mbi mbledhjet e Komitetit të Investimeve Strategjike;
 - h) zbaton urdhrat dhe porositë e Kryetarit të Komitetit të Investimeve Strategjike apo të kryesuesit të mbledhjes.

Neni 9

Frekuenca e mbledhjeve

1. Komiteti i Investimeve Strategjike mbledhet në të gjitha rastet kur paraqiten nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve propozime për investimet strategjike.
2. Gjithashtu, në rastet kur është e nevojshme në zbatim të ligjit ose shihet e arsyeshme, Kryetari mund të thërrasë mbledhjet e KIS dhe jashtë radhe.

Neni 10

Njoftimi i mbledhjeve

Sekretariati teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike merr masat duke njoftuar paraprakisht, të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjeve, me shkrim, anëtarët dhe personat pjesëmarrës për thirrjen e mbledhjeve të KIS dhe për çështjet që do të diskutohen në to.

Neni 11

Rendi i ditës

1. Mbledhjet e Komitetit të Investimeve Strategjike zhvillohen në bazë të një rendi dite të përcaktuar nga Kryetari me propozim të Sekretariatit. Në mungesë të Kryetarit, Zëvendës Kryetari vendos për rendin e ditës.
2. Në rendin e ditës përfshihen:
 - a) çështjet e propozuara nga Sekretariati dhe të miratuara nga Kryetari ose në mungesë të tij, nga Zëvendës Kryetari.
 - b) materialet bashkëlidhur për çdo çështje që do të diskutohet në mbledhje.
3. Në raste urgjence, KIS mund të vendosë edhe për çështje të cilat nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

Neni 12

Kuorumi i mbledhjeve

1. Mbledhjet e Komitetit të Investimeve Strategjike janë të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, një prej të cilëve duhet të jetë Kryetari ose Zëvendës Kryetari.
2. Komiteti i Investimeve Strategjike vendos për çështjet e diskutuara me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të tij. Anëtarët e Komitetit të Investimeve Strategjike nuk mund të abstenojnë.

Neni 13

Deklarimi i pengesave ligjore

1. Në rastet kur një anëtar i Komiteti të Investimeve Strategjike është i prekur nga një pengesë ligjore sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave, ai duhet të lajmërojë menjëherë Kryetarin e KIS.
2. Kryetari merr vendimin për përjashtimin nga votimi të anëtarit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
3. Anëtarët e Komitetit të Investimeve Strategjike që kanë pengesë ligjore për të votuar nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe gjatë votimit.

KREU III

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Neni 14

Funksionet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (në vijim AIDA), në përputhje me legjislacionin mbi investimet strategjike, kryen të gjitha veprimet paraprake për vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe investimeve strategjike të paraqitura. Për këto veprime, AIDA raporton pranë KIS mbi ndjekjen dhe zbatimin e të gjitha detyrave dhe procedurave të parashikuara në planin e veprimit që nga momenti i paraqitjes së një propozimi investues e deri në përfundimin e të gjitha procedurave administrative të parashikuara nga legjislacioni, për realizimin e projektit investues.
2. AIDA verifikon dokumentacionin e depozituar nga subjekti i interesuar dhe kryen vlerësimin e projekteve, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara nga legjislacioni mbi investimet strategjike.
3. AIDA bashkëpunon me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, në lidhje me realizimin e detyrave të saj.
4. Në përfundim të procesit të vlerësimit paraprak, AIDA informon KIS për projektet e paraqitura, procedurat e kryera, analizën dhe rekomandimet e hartuara prej saj. Çdo aplikim i paraqitet për shqyrtim KIS, i shoqëruar me rekomandimin, “pozitiv”, “për plotësim” apo “negativ”, të agjencisë, për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik”, “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.
5. AIDA, në rastet e parashikuara nga legjislacioni mbi investimet strategjike dhe pas miratimit nga ministri përgjegjës për ekonominë, mund t’i propozojë KIS që të autorizojë agjencinë apo ministrin përgjegjës të linjës, sipas projektit specifik, për negocimin, lidhjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të mirëkuptimit apo marrëveshjeve detyruese për palët, në të cilat parashikohen të drejtat dhe detyrimet e shtetit shqiptar dhe të investitorëve strategjike.
6. AIDA njofton me shkrim propozuesin në lidhje me vendimin e KIS mbi miratimin, kthimin për plotësim, refuzimin apo revokimin e statusit “projekt me potencial strategjik”, “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

Neni 15

Bashkëpunimi ndër-institucional

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rastet kur për qëllimet e realizimit të funksioneve të saj në lidhje me investimet strategjike, i nevojiten të dhëna apo informacione që disponohen nga një institucion tjetër, ka të drejtë që, nëpërmjet procedurës së përshpejtuar, të kërkojë nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore që t'i sigurohen të dhëna, informacione apo çdo lloj ndihme tjetër, të cilat janë të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale.
2. Organet publike shtetërore të cilat marrin një kërkesë për informacion nga Agjencia, duhet të kthejnë përgjigje për kërkesën për bashkëpunim sëbashku me informacionin dhe të dhënat e kërkuara brenda një afati maksimal prej 7 (shtatë) ditësh pune.
3. Afati për kthimin e përgjigjeve fillon nga e nesërmja e protokollimit të tyre në institucionin përkatës të cilit i kërkohet informacioni dhe mbaron në ditën e fundit të afatit të përcaktuar, brenda orarit zyrtar të asaj dite.
4. Institucioni pritës, për shkaqe me rëndësi dhe duke dhënë një përgjigje të arsyetuar, mund të shtyjë përgjigjen e tij përkatësisht sipas rastit deri në 3 (tre) ditë pune të tjera.
5. Në rastin kur kërkohen të dhëna apo informacione, për të cilat kërkohen njohuri dhe ekzaminime të posaçme, afati për kthimin e përgjigjes është jo më shumë se 20 (njëzet) ditë pune.
6. Në rast se përgjigjja, informacioni apo të dhënat e kërkuara nuk janë të plota, AIDA ka të drejtë të kërkojë plotësimin e saj me të dhënat apo informacionin e duhur, brenda 3 (tre) ditësh pune nga marrja e kërkesës për plotësim informacioni.

Neni 16

Grupi Operacional

1. Asistenca dhe mbështetja ndaj investimeve dhe projekteve strategjike, kryhet nga Agjencia, nëpërmjet grupeve operacionale të krijuara pranë saj, të cilat janë grupe pune të ngritura posaçërisht, për çdo projekt të investimeve strategjike. Grupet operacionale përbëhen nga ekspertë, teknikë dhe profesionistë të ministrive të linjës, në fushat në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik.
2. Grupet operacionale, ngrihen me propozimin e Agjencisë dhe me nismën e ministrit përgjegjës për ekonominë, me anë të një urdhri të përbashkët të ministrave të përfshirë në projektin e investimeve strategjike. Me qëllim respektimin e afateve të përshpejtuara të procedurave administrative të investimeve strategjike, ministri përgjegjës për projektin strategjik, brenda 10 ditësh nga marrja e kërkesës nga ministri përgjegjës për ekonominë përcaktojnë personat pjesëmarrës në grupin operacional, si edhe personat/strukturat e kontaktit të cilët do të jenë përgjegjës për komunikimet me Agjencinë në lidhje me investimet strategjike.
3. Urdhri i përbashkët për ngritjen e grupit operacional për realizimin e një projekti ose investimeve strategjike përcakton;
 - a) qëllimin e ngritjes së grupit të përbashkët të punës;

- b) objektin e grupit të punës;
 - c) funksionimin e grupit të punës në strukturën e Agjencisë;
 - d) numrin e punonjësve që do të përfshihen në grupin e punës dhe ndarjen e detyrave përkatëse;
 - e) rregullat mbi vendimmarrjen e grupit;
 - f) përcaktimin e infrastrukturës, nëse është e nevojshme;
 - g) mjetet financiare, nëse është e nevojshme;
 - h) afatet, brenda të cilit grupi i punës duhet të realizojë detyrat e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë".
4. Grupi operacional kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë i cili përfaqëson grupin operacional në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe investitorët strategjike.

Neni 17

Funksionet e Komitetit të Investimeve Strategjike

1. Komiteti i Investimeve Strategjike, pas shqyrtimit të projektit dhe të analizës përfundimtare të paraqitur nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, merr një vendim, brenda një afati 30-ditor, nga data e dorëzimit të propozimit.
2. Në rastet kur Komiteti i Investimeve Strategjike konstaton se dokumentacioni është i paplotë apo ka nevojë për informacione shtesë, nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, i kërkon propozuesit të projektit, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike. Propozuesi i projektit duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit. Në këto raste, afati 30-ditor i vendimmarrjes zgjatet deri në plotësimin e dokumentacionit dhe shqyrtimin përfundimtar nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike.

Neni 18

Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike

1. Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me projektet e investimeve mund të kenë si objekt:
 - a. miratim;
 - b. kthim për plotësim;
 - c. refuzim;
 - d. revokim;
 - e. aspekte të tjera sipas kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni mbi investimet strategjike.
2. Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike përmbajnë numrin, datën, nënshkrimin e kryesuesit të mbledhjes, të Sekretariatit Teknik, si dhe vulën e Komitetit të Investimeve Strategjike.

3. Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike të cilat miratojnë statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, përmbajnë gjithashtu, edhe elementet e mëposhtme:
 - a. titullin e projektit investues;
 - b. vlerën e parashikuar të kapitalit që do të investohet;
 - c. emrin e investitorit të interesuar dhe partnerëve të tij;
 - d. llojin e projektit investues;
 - e. vendin/zonën ku do të zhvillohet ky projekt investues;
 - f. afatin për të cilin jepet statusi “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”.
4. Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike i njoftohen propozuesve të projekteve të investimeve strategjike nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, regjistrohen dhe publikohen në regjistrin e investimeve strategjike.
5. Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike u shpërndahen edhe organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të cilat kanë kompetenca në lidhje me investimin strategjik.

Neni 19

Procedura dhe afatet për miratimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve

1. Me qëllim realizimin e projekteve të investimeve strategjike të cilat kanë përfituar statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” dhe që kanë nevojë, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, për pajisjen me leje, licenca, autorizime, apo miratime të ngjashme, AIDA asiston investitorët strategjike gjatë këtyre procedurave duke ndërmjetësuar në marrëdhëniet me organet shtetërore kompetente. AIDA brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së dosjes së plotë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga legjislacioni sektorial për miratimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve, së bashku me mandatpagesat e tarifave përkatëse, ia përcjell dosjen e investitorit strategjik organit kompetent për lëshimin e tyre.
2. Organi kompetent për lëshimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve, me marrjen e dokumentacionit nga AIDA, brenda 15 ditëve pune, lëshon këto dokumente, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Përrjashtimisht dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e lejeve, licencave dhe autorizimeve, afati mund të shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohe 15 ditë pune.
4. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur rezulton të jetë i paplotë ose i paqartë, organet kompetente, nëpërmjet Agjencisë, i kërkojnë investitorit strategjik, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike.

Neni 20
Përgjegjësitë dhe masat administrative dhe disiplinore

1. Nëpunësit publikë dhe punonjësit e ministrive dhe organeve të përfshira në procesin e realizimit të projekteve strategjike, kanë përgjegjësi zbatimin e detyrave të përcaktuara nga legjislacioni mbi investimet strategjike. Veprimi ose mosveprimi nga nëpunësi publik apo punonjësi, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konsiderohet mospërbushje e rëndë e detyrës dhe përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore.
2. Shkeljet e dispozitave ligjore të legjislacionit për investimet strategjike, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas sanksioneve të parashikuara nga neni 33 i ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYETARI

NIKO PELESHI